

DOKUMENTA E MATERIALE

Prof. Dr. ALEKSANDËR XHUVANI

FJALË DHE SHPREHJE TË SHQIPES

Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani, krahas veprimtarisë së tij të shumanshme, gjatë shumë vjetve, i qe vënë mbledhjes me zell e dashuri të fjalëve e shprehjeve frazeologjike shqipe kryesisht nga goja e popullit, por, në një farë mase, edhe nga disa vepra të shkruara, duke synuar të hartojë në një kohë të mëpastajme një vepër leksiko-grafike në llojin e fjalorit të Kristoforidhit, që ai kishte ndër mend të quante «Kristoforidhi i vogël». Ai, u përpoq të kapë në radhë të parë përdorime, kuptime, fjalë e sidomos shprehje që s'figurojnë në fjalorët më të njohur të shqipes, sjellin diçka të re saktësuese a plotësuese ose lejojnë të fitohet një ide e qartë për shtrirjen e sferës së garkullimit të tyre. Me njohjen e gjerë e të saktë të pasurisë leksikore të gjuhës sonë që zotëronte ky lavrues e studjues i shquar, me qartësinë e cilësitë e tjera që e karakterizonin, vepra e projektuar do të ishte një kontribut i rëndësishëm me vlerë të veçantë në fjalorin e përgjithshëm të shqipes, në studimet leksikologjike, e gjuhësore në përgjithësi. Po ai s'pati kohë të shkojë përtej fazës regjistruese të parë të materialeve, pa arritur të bëjë përpunimin e tyre, as edhe verifikimet e plotësimet e nevojshme, as sistemimin.

Materiali i pasur leksikor e frazeologjik që la Prof. Dr. A. Xhuvani, i përbërë prej 30000 skedash, nga të cilat mund të dalë një vepër leksikografike prej rreth 13-14000 fjalësh të një vëllimi prej më se 1000 f. të daktilografuara, po sistemohet e përpunohet në formë fjalori nga Mahir Domi e Qemal Haxhihasani.

Me rastin e 10-vjetorit të vdekjes (22.XI.1961) me nderim të veçantë për kujtimin e kësaj figure të shquar të gjuhësisë shqiptare, po botojmë pjesë nga kjo punë me aq interes për leksikografinë, leksikologjinë e dialektologjinë shqipe. Herë-herë për fjalët është shënuar vëndi i të mbledhurit ose i prejardhjes së subjektit apo autori e vepra nga është nxjerrë. Emrat e tyre po jepen të plotë ose me shkurtime. Kur ka qenë e nevojshme, janë bërë referime në disa fjalorë. Me FGJSH kemi dhënë «Fjalor i gjuhës shqipe», botim i Seksionit të gjuhës e të Letërsisë të Institutit të shkencave, Tiranë 1954.

babanace-ja *ef.* bukë misri e papjekur mirë (e pakulluar mirë): një dërre — e papjekun fare; nuk e kullove një çikë, po e ke lënë — bukën (Myzeqe).

babarage-ja *ef.*; 1. të ftohët: i shtiu — n, mora — n = më hynë të dridhurat nga të ftohtit; 2. frikë, drithtim, (panik): më shtiu — n = më trembi, më tmeroi (Elbas). Edhe **babërage**, **beberage**: i shtiu **babëraqen**, **mora beberaqen**. Krhs *buburiqe* = rreqethe (Tir.)

babaxhan- i em; një farë zogu i natës, lat. *strix flammea*, nga it. *barbagiani*, frengj. *barbe à Jean*.

babëzi-a *ef.*; 1. grykësi e madhe; lakmi e madhe; panginjësi, pangopësi; e ka zënë -a = ha e pi shumë; lakmon tepër; fr. *gourmandise*; *voracità*; 2. prapësi,

varfëri: *na pruri -në*, gr. *χουρδουγία*; *mos rri ashtu, se na sjell -në* (Him.); *gjum i shumtë është* = varfëri; mjerim: *pse të jesë Shqipëria / ta mbulonjë - a? kohërat e mesme qenë të gjithë luftë, zjarr, egërsisë*. — (= mjerime) *e shkretëtirë* (N. Fr., Ist. Përgj. 76); 3; *zihje, grindje e mjerësi; e ka zënë -a* = shfryn, grindet.

babëzi *mb*; *lakmues*, i pangopur, i babëzitur

babëzitur (i,e), *mb. lakmues; i pangopur: mos ha ashtu i — = me lakmim shumë, i pangopur.*

babëzot-i, babzot-i *em. gjysh-i; FGjsh: babazot-i.*

babëzuar (i,e) *mb. i pangopur, i babëzitur.*

bablok-e *mb. njeri i patëkeq, i pasherr, baballëk; it. bonaccio.*

bablok-u *em. gjyshi, baba i babës.*

babole-t *ef. shm; herdhe-t. edhe: bole, mbole, xhabole* kra. frigjishten *βάμβαρον.*

babune-ja *ef., masë drithi e barabartë me 6 1/2 okë, ka 4 korriqe*

babunjosur (i,e), **bubunjosur**(i,e) *mb. i fryrë, i mbufatur, (Pogradec). gjermë aufgeblasen, aufgetrieben* krs. e *zunë bubujt* (Elbasan)

bac-i *em shm. -a; top dheu, bore: një — vdore, toke, dheu* (Lumë); *me gjuejtë me -a toke* (Kosovë); *një — tokë, gjë — borë; plis dheu, Sh. edhe bas-i, basë-a, basë-a, bucë-a*

bacar-i *em; lakror me miell misri e me lakra shumë; edhe: bacarok-u*

bacarak-u *em; lakruar, byrek me miell misri e me preshe a me kungull* (Përm.); *sh. bacar, bacarok.*

bacarok-u *em; bacar, lloj lakrori*

bacë-a *em; me këtë emën thirret baba i vërtetë a gjyshi, ose vëllai më i madh; pastaj ky emër, për nderim, u ngjitet edhe njerëzve të shtyrë në moshë; p.sh.: baca Prekë, baca Sulë etj. Si ky emër i fundit është edhe emri migjë: migja Prekë.*

bac/ë-a *ef; plis katërsqepash me bar* (Elb.); *sh. edhe bâzë, bâc-i, bas-i; bucë; plit.*

baç-i *em; ushkur* (Dibër); *edhe: balç-i e barq-i*

baçiçë-a, baxhic/ë-a *ef; ajo që kujdeset për stanin e punon bulmetin në stan; thuhet edhe: stanore-ja, shtëpresë-a.*

badër-a *ef.; bimë, iris germanica; FGjSh: bimë nga familja e Liliacevet, asphodelus.*

baduri *ndf; ecin dhent — = tufë, njeri pas tjetrit, kur i ndiell çobani; krs. boroni a barani.*

baganace-ja *mb. ef; e përtuar, e plogët, e qullët, e gjymtë: -s nuk i vjen doret as të krifet; hap sytë se mos të zërë derën ndonjë — ; -ja të zen derën me drizë, (Tomorr.)*

baganace-ja *ef; babanace, bukë misri e pakulluar mirë në të pjekur: mbushja trajstën Manes me — ; Vetëm për t'u mufatur me — pa për punë s'e kruan* (Tomorr).

bagatar-i *em; çoban, rrejtës i bagëtivet* (Kurvelesh).

bagë-a *ef; sëmundje e rëndë që u bie kualve nga ngarkesa e rëndë dhe u ëj këmbët* (Veri)

bagëlit *fmk; bën bagla: gomari, kali —.*

bagëtisht *ndf; në mënyrën e bagëtisë, si bagëtia: të jetuar njerëzisht, të ngjallur —* (Vreto).

báhe, bahé -ja *ef; hobé, sabé, bozë-a, edhe: behë-a*

bajëz/ë-a *ef shms; -a-t, bajazë-t* shpezë të egra që rrojnë nëpër moçale, kënetat a lëqere dhe ushqehen me peshq a me krimba uji; nga ngjyra e pendës shembëllejné me rosa të egra, po nga shtati janë ma të vogla (Myzeqe).

bajg/ë-a *ef., bajz/ë-a* *ef; m'u ndezën bajgat = m'u ndezën nervat; këto marifete të zojshës kishin filluar t'ja ndezin bajzat të shkretit Gjino.*

bajgos *fmk*; bën bajga: — *kali*; **bagëlit**

bajukë-a *ef*; lopë me një pullë të bardhë në ballë e me trup të kuq ose të murrëm; edhe Gaz. 52 për Kelmend, bashkë me: *lopë e bajë, bajme*.

bakull-i *mb., em. shm.* **bekuj** i shëndoshë, i fortë: *burrë—, kam djalin — bal-i* *em*; dash a qen i bardhë

balç-i *em*; 1) gjalmi për të lidhë brekët, ushkuri; **ballç, balç** 2) **bâlç-i, barç-i, baq-i**; 3) një farë konopi prej penjësh leshi që përdoret prej gravet për të bajtur dru, bucela a djepe.

bále-ja *ef*; dele e bardhë.

balé-ja *ef*; dhe e bardhë.

balë *mbf*; dhi me ballë të bardhë ose me njolla të bardha; **balike, baliskë**; dele e bardhë që ka njolla të zeza; *efm. -a = lopë me shenjë të bardhë në ballë; dhi a dele e larme.*

balik-u *em.* emër i një qeni të madh (Korçë); FGjSh: qen me njolla të bardha.

balike *ndf.* dhi e balër, me ballë të bardhë; **balé, baliskë.**

baliqe-ja *ef*; lopë me shënja të bardha në ballë, **baliskë, baloshe, balushë baliskë-a** *ef.* 1) pulla e bardhë që kanë zakonisht bagëtia në ballë; 2) lopë me shënja të bardha në ballë; dhi me ballë të bardhë; dhi sybardhë. Edhe: **baluskë-a baloshe-ja** *mb. ef*; dhi me lule (rrenja) në ballë (Lumë); dhi e larme; lopë me shënja të bardha në ballë; **balosh-i** *em.* kau i larëm a me ballë të bardhë

balsuke-ja *ef*; *shms. -t*; flokët (leshërat, qimet) përmbi ballë që u lanë sidomos fëmijëvet (Myzeqe).

baltak-u *em*; baltë e madhe; sh FGjSh *mb. -, = e = me baltë* (thuhet për një vend).

baltëm-e (*i,e*) *mb, l mb*: heja-e = pa shije, frgj. *insipide*, sh. (*i,e*) *bar-temë*; Gaz. 53: *hae, dardhë e balteme, asht baltë haeja* (= është bërë e amshtë, e pashije).

balteme-ja (*e*) *ef*; *ka marrë të — plaga = është zbutur.*

baltë-a *ef*; 1. *Ai të le në -t = s'të vjen në ndihmë, të lë vetëm, të del fjalës; më la në -t, e la në —*; 2. *u bâ —* (pema, rrushi, drithi) = ka shumë dhe prandaj e humbi vlerën; u bë lirësi e madhe; *u bâ — diçka = pa vlerë; e bani —*; *baj —* një punë = e shpërçmoj; 3. *bahem —, i bahem —* (dikuj) = i përulem shumë, poshtërohem; frngj. *s'humilier*, sh. edhe it. *essere servile*; 4. *s'është e drejtë të hamë — me dhëmbë gjithë jetën = të vuajmë*; 5. *ngrihet -a këmbëshit = të vjen jiksht, kur thuhet e bëhen gjëra pa vend.*

balt(ë) dosë-a *ef*, shtazë nga klasa e sisorëve, **baldosa, dosëbala, vjedulla, vjellës-i**; frgj. *blaireau*, gjerm. *Dachs*

baltërt(i) -ë(e) *mb.* prej balte: *në një enë të —*

baltok-u *em*; baza prej balti në trajtë koni, ku qendron boshti i përçakësit (shtjelljes), ku mblidhen pejtë (Sulovë, Q. Haxhihasani); **cididum-i**

baltore-ja *ef*; 1) enë uji prej balte, katruve (Lazarat, Gjir); 2) vegël në formë konike prej balte, ku pështetet maja e shkopit të dollapit të kafesë për ta rrotulluar.

baloz-i *em; mb*; 1. *em. në këngët popullore legjendare vigani i egër i ardhur nga deti që shtyp e mundon vendin: kurr -it motrën mos m'ja dhanë*; 2. *mb; i madh shumë: derr i madh —* (Mallakastër); 3. thuhet për njeri të madh, të zotin, me cilësi të mira (Krasniqe)

baltosem *fm*; bëhem me baltë; FGjSh: **baltos** = bëj me baltë, **përbalt.**

baltosur(i,e) *mb.*; bërë me baltë, i lagur me baltë: *ara është e —.*

balushe-ja 1) lopë me shënja të bardha në ballë; 2) dele a dhi me xullufe në ballë kaçirubë

balushë-a *ef*; 1) lopë me shenjë të bardhë në ballë; 2) dele me kokë të zezë.

balladër-a *ef*; ujëvarë, thefqafë; edhe **ballandër-a** (FGjSh).

ballç-i *em*; brezëmbrek, ushkur; sh. **balç-i**, **baç-i** **baçiq-i**.

botinë-a *ef*; vend lagshtinë; Fj. i Bashk. fq. 19 = acquitrino, terreno pregno d'acqua; mos vjen nga: vend botë?

bozë-a *ef*; hobë-ja, bahë-ja, (Lumë)

bozë-a *ef*; 1. *u ba — ujët* = u trubullua; 2. *u ba = malli* = u lirua.

bozhë-a *ef*; shpezë uji që ushqehet me peshk, i ngjan lelecut, por pendët i ka në ngjyrë hiri, femër e **bozhor-it**,

bozhor-i *em*; nositi, paci, pelikani mashkull, sh. **bozhë!**

brabëll-a *ef*; njëra gërryese e ostenit; krhs. **barbull**

brac-i *em*. 1. vjedhës gjërash të vogla, si pemë, pula etj., it. *ladruncolo*; femër. **bracë-a** (Lumë) = hajneshë; 2. batakçi, i lig, e ligë (L.); 3 njeriu që don të hajë çdo gjellë ose pemë që sheh (Dibër). Sh. edhe **bracar-i**.

bracar-i *em*; brac, hajdut pazari që vjedh sende të vogla (Tir.).

bracni-a *ef*; braci, vjedhje e vogël: — *e bame prej fmish*; sh. edhe FGjSh: **bracoj** = 1 vjedh gjëra të vogla; 2. mashtroj.

braç-i *em*; vjedhës i ulët, ai që vjedh gjëra të vogla; vjedhës; **braç-i**

braf *pasth* — *n'kamë kenka çue*; *praf*

brafullak *sh*; *brufullak*

brafullon *fjk*; del me shumicë (Elb.); krhs. Gaz 71 **brufullon** (M. e Madhe) *bari*, *brufullojnë krymbat* = rihet bari me shumicë të madhe, dalin krymba me shumicë të madhe.

bragaç-i, **brakaç-i** *em*; enë e thellë prej bakri (përkatësisht Gjir. e Him.) bakraç; FGjSh. *bakraç*, *bragaç*.

brajë-a *ef*; bullungë që del në trup të njeriut, të kafshëve e të bimëve; frgj. *excroissance*; sh. edhe FGjSh.

bram-i *em*. dram-i, dra-u, fundërria e gjalpiti që mbetet në fund të enës, kur e shkrijnë; ajo që mbetet nga mjalti kur e shtrydhin, Fj. Bashk. 49; fundërrina e çdo gjëje të tretur: *-i dyllit*; *-i hekurit* = zhiri, zgjyra; llomi i ujit që bie në fund të enës (Mat).

bramall-i *em*; njeri që flet fjalë pa i matur mirë (Shingjergj i Tiranës).

brambull, **brumbull** *ndf mb*; me flakë të madhe: *kishte ndezë një zjarr brambull a brumbull*; sh. FGjsh *fmk brambullon e brumbullon* = digjet me flakë të madhe duke kërcitur.

bran(ë), **branazi** *ndf*. *zvarë*: *lera hiqet branë*; *rrshan*, *zharg*.

branë-a *ef*; almise bujqësore që shërben për të thyer plisat, lesë, trinë.

brakaçe-ja *ef*; bakraç; (Elb., Pogr.); **bragaç-i**, **brakaç-i**

brashanike-ja *ef*. fëmi që lind pa kohë

brashjë-a *ef*. brashnje, shkarpë, këpucë e grisur që s'mbahet më këmbë (Gjirok.)

brashnj/e-a 1. opinga a këpucë të vjetra të grisura, jashtë përdorimit; 2. fig. njeri i ulët, pa karakter: *akëcili është, sillet si—*.

brashnjar *em*; 1. ai që arnon këpucët, arnestar (FGjSh); 2. këpucëgrisur; rrugaç.

bravare-ja *ef*. 1. ajo dele ose ajo dhi që shkëputet nga kopeja, që nuk i shtrohet kopesë dhe kullot vetëm; 2. ajo dele a dhi që ja japin një bariu bashkë me të tjera të fshatit; kullosin gjithë ditën e pastaj mbrëmavet i bie bariu dhe shpërndahen ndër shtëpia; (slavizëm).

brazë-a *shm*; **-a-t brazd/ë-a** *ef*. 1. vija e parmendës në arë (Myzeqe); 2. *s'bie në brazë*, *s'vjen në brazë* (për dikë) = nuk bindet, nuk i mbushet mendja, d.m.th. nuk shkon udhës, vijës së drejtë si kau në parmendët.

brazim-i *em*; vesë e hollë që bie në mëngjes dimrit, kur bie shumë është shenjë shiu (Vlorë).

brazimë-a *ef.* 1. brymë, sh. *brazim*: bimët duhet të ruhen prej -s; cingërrimë; (nga *mraz* = të ftohtit); 2. borë e hollë me erë.

brazhëllimë-a *ef.*; brazhëm, zhurmë, vervele

brazhëm-a *ef.* zhurmë, brazhëllimë.

bre-ja *ef.* Sëmudje që e bren lëkurën e mishit (Lumë); krhs. *brie* Gaz. 69.

brë-u *em*; **në** — të pyllit (Tir.) = aty ku fillon pylli, në bri të pyllit (nga S. Kolea).

brec/ë-a *ef.* ana prefëse e briskut (Kosov).

brec-i *em.* ngastrestar (Neshte e Librazhdit); ndofta nga **brac** = bataqçi.

bredh *fjk* (*brodha, bredhur*). 1. eci: — *me vrap* = eci me rende, ze rendë; shkoj: — *drejt tij*: — *ajo dhe duke* — **ur** thërret me tërë zënë e saj; shkoj prej një vendi në një vend tjetër: **brodhi** *fshat më fshat*; 2. vrapoj, ja jap vrapit, iki së katrash: **brodhën** *të gjithë*; 3. hidhem: **ka për të bredhë** *zemra jote prej gëzimit*.

bredh² *fk*; 1. luaj ,loz një tavël, një lodër (Çamër.); 2. *fjk*. luaj, bëj shaka (arbërisht edhe në Shqipëri të mesme, në Labinot të Elbasanit).

bredaas *ndf.*; *vjen — bora*

bredhëz-a *ef shm.* -a; copëz guri, kokën e një sendi, brek: *mbështill ca -a guri për vëshnakun, mbështill ca-a bujashkë për zjarr* (Tomor.); edhe **brez**, *shms -a*.

breg-u *em*; **brek-u** *em*; 1. një copë e vogël: *një — djathi; ja tek është — u i gurit* = copëza e gurit; *një — sheqeri* = tokël sheqeri; *kokërr = merr atë — misri*; 2. lëmsh, top i madh: *shtohet e madhohet si një brek dëbore* që rrungulliset nga nji mal; 3. **dal në breg** = dal nga vështirësitë, **kjo na qit në** —; *unë dua ta qis në breg* shokun = ta shpëtoj.

bregabunas-i *em*; banori i Bregut të Bunës, krahinë e Shkodrës.

bregal-i *em*; sop i lartë, sh. edhe **bregël-a**, **bregole-bregolja** (FGjSh) = breg i vogël.

bregalumas-i *em*; banori i bregut të lumit (Shkod.)

breishtë-a *ef*; pyllë breu

brej *fk*; 1. *na brejti me grindjet e tij, që nuk fle e nuk rri rehat ai fëmi* (ose dikush tjetër) = na mundoi s'na la rehat; *nakari bren zemrën e njeriut; më brejti me këtë*, për një që kërkon gjithnjë një gjë, *iu ka brejtë jeta, shpirti* (Lumë) = ka vuajtur shumë; 2. *s'un e brej atë mësim* = s'mund e kuptoj; 3. *të brejnë rresh-tnat* = të ha kurrizi, do rrahur.

brekinjë-a *ef*, katund me kodra, i Tropojës; nga *brek-bregu*, formuar me prapashtesën **-injë**, krhs. *shme*. e *dash*: **deshinj**.

brektrashe-t *efshm*; kofsharët

brekthes-i *em*; ai që i ka brekët si thes

brelinë-a *ef*; borë e lehtë (Polis i Elbas.); mos vjen nga **brerimë** = të ftohët me shi e me erë (FGjSh) e kjo fjalë nga *breshërimë*?

bremë-a *ef*; ngarkicë: *nji — dru, nji — qymyr* = barrë dru, nji barrë qymyr (Tir.)

bremë-t (*të*) *eas*: **të** — *e zemrës shpejt ja përtërinë ethe*.

brendësi-a *ef*; pjesa e brendshme: *shirat hyjnë fellë në -në e tokës*.

brendësm-e (i,e) *mb*, i brendshëm; *ishte gjithnjë në luftë të brendësme* (N.Fr.)

brendshëm (i) — **brendshme** (e) shumë i afërt, fr. *intime*, gr. *οἰκαιοσ*.

brenë-a *ef*; 1. gorre e thellë: *kët tokë e hangri —∞* = iku, u shëmb; *kjo tokë ka — reposh*; 2. tokë që shembet; kur shembet ndonjë copë dhe e madhe prej së larti e zen vend (Pajove e Peqinit), **sheme** a **shembe**, it. *frana*,

brenë-a² *ef*; lesa, trina që sheshon plisat (Lum.)

brenë-a³ *ef*; thupër; purtekë për të shkundur arra, gështenja etj. (Fj. Bashk. 50).

brëngë-a *ef*, *shms -a*; hidhërim, hall: *unë e di sa -a kam; i ati duke i venë re*

-at e së bijës (= si kellxhimet e së bijës); -at e **ngrenëjet** (= ἔριδες) e trazimet ishën të paprera.

brengim-i em. shm; -e hidhërim, brengë, hall: *kemi shkuar me hidhërimet e me -e të thella; për mua mos kini asnjë —; nga — i madh që ka se do të niset, ai s' del jashtë fare; mos kini ndonjë — për mua, se jam mirën = mos u shqetësoni; nga turbullimet e nga -et e harruem fare këtë gjë = nga trazimet e hallet.*

brengos fk; hidhëroj: *po vetëm një gjë e -te... ky ndryshim i papandehur i saj e — te aqë shumë sa i priteshe e ngrëna; -em* fm., hidhërohem: *kur do të dëgjojë ikjen time, do të -et; mos -uni, po neve ndarja na hidhëron shumë = mos bëhi merak; s'të kam thënë, se e dija që do -esh shumë = do ta zerë halli, merak; të shohç. Mezon, s'e njuh, kaqë është -ur nga kjo punë = e ka zenë halli, është sëkëlldisur, është shqetësuar.*

brengosur (i,e) mb; i(e) hidhëruar: *shkova shumë i —, rrij shumë e — se gjer atëhere s'i kish lindur ndonjë fëmi; rrij i mejtuarë e i — që s'kemi marrë letër nga djali = jam berë merak; i — prej ndonjë halli; greq. στενοχορημέως, i hunduem, melankolik: rrinte e — duke menduar në dhomë të saj.*

brenoj fk. lesoj, sheshoj me brenë plisat (Lumë)

brens-i em; brisk me të cilin kruhet buka

brenim-i em; 1. shi i madh, shi i shumtë, i ngadalshëm, i vijuar, që mba shumë (Gjirok.): *sot qe një —; shi i madh me vrull; 2. të ftohët i thatë me erë (Gjir.)*

brerimë-a ef; kohë e keqe me erë të ftohët; *sot nuk do dal jashtë, se është një —; ndoshta shkurtimi i fjalës breshërimë.*

breron fpv; bie shi i madh, bulëmadh.

breruar-it eas; të rënë shumë shi, ngadalë e vijueshëm (Gjir.)

breskë-a ef; dhi e zezë me vija të bardha në bark e në shpinë; (Përm.) emër dhije me ngjyrë hiri e të bardhë.

brestkë-a ef, brestkosa (Him.)

breshëllirë-a ef, thuhet për një ëmbëlsirë që është bërë e shkoqur si breshëri dhe jo si qull, p.sh. hasudeja.

breshëni-a ef; *ban vajin posi shi e —*

breshër-i em; *si — i vinin lotët; plumbat binin si —.*

breshërimë-a ef; 1. breshër; 2. breshër i madh (Sulovë e Gramshit). 3. breshër i hollë (Tir.); breshër i pakë; 4. diçka e shkoqur si breshëri: *dhe —; dhe i shkoqur —, dhe i thermuar si kokrra breshëri.*

breshkan-i em, mashkulli i breshkës (Shpat i Elb.)

breshkaq-i em; njeri me breshka në fytyrë e në shtat (Vl.).

breshkë-a ef, 1. *si — nëpër plisa = me mundim; 2. mëllë, frgj. excroissance.*

breshnoj fk; kristalizoj; **breshnohem**, kristalizohem. it, cristallizzarsi; edhe **brishtnoj**, **brishtmohe** (S. Kolea)

breshhtë (i,e) mb; 1. i brishtë, i thyeshëm; 2. i egër.

brêt-it (të) eas; të brejturit: *desh me ua mshehë prindëre të vet të — it e zemërs.*

bretk-u em; 1. sëmundje e barkut; **ç'bretk ke?** thuhet kur grindet kush; *t'i kllas -un; ç'i kllat — un ç'bretk! = të preftë (mallkim); — un, jo çupën t'i jap; na kalli — un = na futi në vështirësi; 2. më bie -u duke punuar = punoj shumë; më ra -u duke qepur, qëndisur (e gjithësi duke bërë punë të rënda) = lodhem shumë, këputem; i ra — u nga punët e shumta; bujkut i binte — 12 muaj viti duke punuar çifligjet e pashallarëvet; atyre u ra -u duke thënë: ç'bëhet ujku në pazar? = ata u lodhën se thëni... .*

bretkosë-a ef; *zu të vjellë -a*, thuhet për një njeri që zë të llomotitë e të shajë.

brevë-a ef, një farë gjarpëri me ngjyrë si të zezë, nja 15 cm i gjatë dhe dy gisht i trashë, që e pështjell gjahun e tij dhe pastaj e ha; — e gjarpërn paçi motr'e vëlla (mallkim); *m'u bane — mos u ngifsh (mallkim).*

brez-i em; 1.: — mbas — frgj. *d'une génération à l'autre; 2. lëshoj -in* (për ta

shkelur ai tjetri e për t'u kapur me të) = kërkoj të ze sherr; 3. (Myzeqe) thërrime, kokërr: *nuk ka -n e kafes*.

brezmek-u em. ushkuri, rripi që lidh të mbathurat (Malëshova e Këlcyrës); *brezëmbrek-u*.

brezore-ja ef. një farë këmishe (Shinavlash).

brezore-ja² ef, revole brezi (Kosovë)

brezore-ja³ et. revole brezi (Kosovë),

brezvënë-i em, mb; që ka vënë brezin e zi se i ka vdekur i afërmi, e përzishme.

brëshnjëdar-i em. njeri me këpucë të grisura; sh. edhe **brashnjar**.

bri pf, përbri: — *Drinit*.

bri-ni em; **bri-ri** em; *shtazë-ni*, shtazë me brirë, lopë e qe; *si dhia me një bri*, e shëmtuet; 2. *njeri me një bri*, njeri budallë; 3. *të hanë brirët* = do që të rrihesh.

bri-a et; kokërr e vogël që del në kapak të syrit (VI.) krhs. Gaz. fq. 69 **brie-ja**, **briesë-a** = dergjë qi bren mishin edhe ashtin.

bric-i em, gjëlpëra që i bie fyshekut.

bricë-a et; gur shkrepës, qi qet zjarrm ose shkëndi (Lumë); gur pushke; sh. edhe Gaz. f. 69 **bricë**.

brice-ja ef; lopë me një bri të thyer; FGjSh: bagëti femër me një bri; sh. edhe **bricë**.

bricë-a ef; dhe me një bri, brice.

bridhmë-a ef; **brithmë-a** ef; të bredhurit (Pj. Budi); këcim në valle: *në qishdo lodërti e* — (Pj. Budi, Pasq. 196); nga **breth** = luaj valle (Budi, Pasq. 45).

bridhtë (i,e), **bridhët (i,e)** mb; thuhet për mollë e dardha etj. që janë të buta, që janë zbutë pas të vjelurit dhe derdhen, shkrihen në gojë; shih edhe foljen **bridhet**.

bridhton f; 1. *fk*; *ngrica e — tokën*; 2. *bridhtohet* fm. zbatet: *është bridhtue molla e dardha* = është zbutur, është bërë e bridhët a e brydhët; thuhet për mollë e dardha, kur të rrinë ca kohë pasi të vilen dhe marrin një erë e shije të mirë, duke ia rrudhur herë herë lëkura.

brijë-a ef; **brinjë-a** ef; shums. - a; *rri se të theva brinjët. ja thyej brijët a brijtë*, = e dërmoj, e rrah mirë e mirë e shij brinjës (Krujë) = e sqaq së rrahuri; *pushon brinjët* = shlodhet pas së lodhurit; *i duken brinjët a brijat*, thuhet për një njeri që është i dobët, i ligët; *i numurohen brijt atij* = është tharë, është ligur; *zunë të mbajnë brinjët me dorë nga gazi* = qeshën shumë; *në brinjë* = mb'ijë; 2. e përpjeta e përpjetmja: *kemi tashti një brinjë*; mb.; *arë, kodër, vesh brinjë* = që është pak i pjerrë; 3. *më bie në brijë; i ra në brinjë tashti, por vonë* = e kuptoi, e mori vesh.

brijë-a ef; **brinj-a** ef; enë prej druri 15-20 kilesh për të mbajtur ujë, që e venë në shpinë, kanatë e rrumbullakët prej druri, bucelë e madhe uji që vihet mbi krahë ose mbi krye: *shko e mbushi ato brinja* (Lumë).

brikunorë, brikurorë mbmf, ef lopë a ka me brinj të kthyer.

brimë-a ef. 1. vrinë; skutë: *s'la brimë e ulicë* (Elb.) 2. borxh: *mbylla disa brima (a bira) me këto pare; kam shumë brima për të zanë* = kam shumë nevoja për të mbushur, kam shumë pagesa për të dhënë.

brimë²-a britmë, ulurimë, kuje: *e vuri* —, ia dha të briturit, ja dha britmës; *ja krisi* — s, ja dha kujes (VI.)

brimë-a ef; brymë.

brinca-t efsh; shpatulltat e samarit (Veri), **brinjtë e samarit** (Kolonjë); shih edhe FGjSh: **brincë** = dërrasat e anëve të djepit dhe të anëve të arkave, **brindës-i** em; gur shkrepse; krhs. Gaz 69 **bricë-a**, dhe FGjSh **bricë** = strall, gur zjarri që vihet në çark të pushkës.

brinoke-ja ef. dele me brinj, kërrutë.

brinjazi ndf. nga ana e brinjëve

brinjollem fm; kthehem më brinjë, m'ijë.

brinjorskë-a ef; dele me brirë; sh. **briskë**

brisk-u em, shm; **brisqe**: i ka këmbët — = i punojnë mirë, ecin shpejt; i ka **dhambët** — = i ka të mprehtë; **ujët i ftohtë** — = shumë i ftohtë, që të pret në ballë si brisk.

briskë-a ef, 1. dele me brirë; 2. dhi e bardhë (?) «Bashk.» 92.

brishtë (i,e) mb. 1. i thyeshëm, që thyhet shpejt, frgj. *fragile* (Lumë): *gjash-tarja âsht e* — nga folja *broj*, sh. edhe Gaz. f. 70; 2. vjet i — = vit, visek, *perishtup* (Malësi e Shkod.)

britm-i em.: — i parë, shtatori, — i dytë, tetori; — i tretë, nëndori (Tir.)

britur-it (të) eas; zuri plaka të briturit, ia dha britmës, briti (Peders. Alb. M.41)

brizoj fk; — *binin*, e nduk prej kërhanës me dorë, e punoj lirin, fqollen e lirit me ndonjë rreshtëz (a me bri ?) për ta spastruar.

brobolec-e mb emf; -i, -eja i shkurtër, i trashë dhe fort i vogël (Lumë).

broçkolla efshm. fjalë të zbrazëta, të kota, gjëpura, pallavra: mos thuaj — (Gjirok).

broçkolis fjh them gjëpura, broçkolla: mos —, mos thuaj gjëpura.

brof pth; tregon të ngriturit përnjëherë në këmbë: — *bani - në këmbë dhe zu të flasi* (ose: *muer me folë*).

brof fjk; ngrihem menjëherë: *të ndiemen atë za, - i në kambë; fëmijët -ën* (në këmbë) nga gëzimi e rendën për në fshat.

brofka fshm profka, fjalë të kota, gjëpura.

brojzën-it emsh; dreqërit, djemzit; i kanë hi -it, *âsht me -it* = është nevrikosur.

brokërimë-a ef; vend i mbuluar me ferra, driza e gurë që s'është i mirë për t'u lëruar e për t'u mbjellë; arë që nuk prodhon; (Gjirok.) edhe te Fj. i G. Mey. vend i thepisur; Fj. i P. Tases 15: **bokërinë**; krhs. me **bokë** dhe me **bokëri** (Fj. Krist.); r te *brokërimë* duhet të jetë infiks.

brokë-a ef; 1. masë drithi, gjysëm qasje ose pesë karroqe (Gjirok.) 2. gjë që del jashtë vizës së drejtë, it. *sporgenza*, sh. edhe Gaz. 71.

brolle-ja ef; lëkura, koreja: - e *plagës*, kur ze, ve plaga kore.

broshkë-a f; stoli; -*xhevahiri*.

brucë-a ef; **bruc-i** em; petk i leshtë për burra, me mëngë e pa mëngë; bruci me mëngë, në vend të kaçules, ka llabanen; edhe: **bërruc-i**.

brufull-i em; e enjtur ose gungë drurësh që del në trungje të dëmtuara; sin. **breshkë druri**, gjerm. *Knolle*; sh. edhe Gaz 71.

brufullak-u em; 1. fëmi, djalë i mbushur, i frytë (Elb.); 2. peshk i vogël deti.

brukë-a ef; shqopa (Myz.)

bruknje mbf; **dardhë** -, dardhë e madhe si e verdhë, piqet në korrik.

brukth-i em; një farë bime që e ka rrënjën si patatja, ditën e verës, me rrënjën e saj, të gërryer si kupë, u jepnin fëmijve ujë e sheqer për shëndet.

brumë-brumi em. 1. *ngre* -, *za* -; *erdhi* -i; e *ve në* - *patën a gjelin*, për ta majmun (Mallak.); *s'kam futë erë -i në bark*, s'kam ngrënë fare; 2. *ka* -, - *të mirë*: - *të kesh*, *zu* - = u mëkëmb ekonomikisht.

brumbulit fjk; - *zjarr* = është i ndezur me flakë të madhe (Përm.)

brumje ndf; **dardhë** -, lloj dardhe.

brymos fk; bryj

brumtore-ja ef; magjeja (Arbereshët e Greqisë).

brus ndf; 1. e *kishte oborrin - me dele* = plot, të mbushur me dele (Tir.); 2. e *çoj* - = mirë, me bollëk (Elb.)

brushtull-a, **brushkull-a** ef; **brushtull-i** një farë t'ëmbële e gatuar me miell misri, me sheqer e me mjaltë, me gjalpë a me vaj, me ve, që rrihen e piqen në tepsia.

brushtull-i em. një farë bime me gjethe të imta, lat. *calluna vulgaris*.

brushullë-a bimë që i përngjan lëpjetës, por është e hidhur (Shëngj. i Tir.)

bryc-i em; byc-i, kathi.

brydh fk 1. shkrifëron, shkërmoq: *të ftohtat e - tokën, ngrica e - tokën = e bën të brydhun, e dërrmon*; gjerm. *lockern, zermalben, mürbon*; 2. - **et fm**; *molla -et = ndyket; pemët e forta, si ftojt, vodhet etj., brydhen, të peshtjelluna në kartë = zbuten, sh. bridhtohet.*

brydhët (i, e) mb. (i,e) bridhët, i butë: *molla a dardha është bâ e -ët*; që është i pjekur fort dhe shkrihet në gojë; shumë i butë; *mish i —*

bryktar-i mb em; **burgateshë-a** mb ef; i mjerë, e mjerë; nga **burgëtar** (Malësi e Shk.)

brymë-a et; vesë e ngrirë; ngricë.

brymëshkrirës-e mb; *vapë brymë-shkrirëse* (F.Noli)

brymtë(i,e) mb; çil, çile: **dhi e -** (Sulovë e Gramsh)

brakcinë-a ef; brrakë me ujë të cekët

brram pth; **bani - kur u ul.**

brrolle-ja ef; **brrolë-a** kacarrumi (Dibër).

brryl-i em; -i *qyngut*

brryl ndf; *asht dejë e asht ba -* (Shk.)

dakë-a ef; 1.: *të punoj — n = të punoj qindin*; 2. *mori, zuri — n ky me këtë gjë* (kur kërkon fëmija ose ndokush tjetër një gjë dhe e përmend e s'e lëshon prej gojës atë; - ndoshta onomatope nga **dak, dak, dak**).

dako-ua em; dash që mbahet pas (Libohovë) (Eduk. Re III, 35).

dal fjk 1. **duel shkolla**; **dal në derë**; **dal për dere**; **dal nga dera**; më **duel nga mend, nuk më del nga mendja**; **dal rrugës**; **dal malevet**; **fk. dal derën, lumin**; **porsa dola derën, zu shiu**; e **dal lumin**; 2. **fjk ka dalë mishi i derrit**; **kanë dalë qershitë, fiqtë, kosi etj.**; **kjo shtëpi, ky dyqan, kjo furrë etj. ka dalë e bukur = it. é venuto bella**; **duel shumë i ambël ky pjepën**; **s'duel gja ky njeri, kjo punë**; **kjo gja del në dukë**; **nuk po u del në dritë dishiri i tyne**; **duel i zoti (= u dëftua, u tregua)**; **duket se do t'i dali ndonji plevitë**; **s'dihet se çka ka për të dalë nga kjo = gjerm. sich ergeben**; 3. **i dal përpara ndokujt për ta pritë**; 4. **i del boja kur lahet**; **i doli turpi**; 5. **doli nga fjala**; **mos me i dalë fjalës**; 6. **mbas një moti del ingjenier, doktor**; 7. **ëndëra doli**; **duel fjala se ai po bahej gati për' = gjerm. das gerücht kommt aus, verbreitet sich**; **për këtë duel fjala se iku**; **duelën shumë fjalë atëhere për atë se...** 8. **kështu ka dalë njime** (martohen djemtë vetë); 9 **i ka dalë një punë tjetër**; më **duel një punë sot**; **pse ka ardhur, mos i ka dalë ndonjë punë = it. gli é capitato**; **nuk më duel kohë që të vete atje**; **nuk më duel kohë me e kërkuë, nuk më duel kohë, sira, radhë me ba këtë punë**; 10. **dal mirë në një ndërmarrje a punë = fitoj**; **dal mirë në provimet, në prashitjet, në mbjelljet etj.**; **si dole me ullishtat simjet? si dole në provim**; **qysh dole me konferencën**; **dal mirë në lojë**; **dal keq = humb**; **ja dal punës**; **dal faqebardhë**; **nuk di se ku do të dalim me këtë punë, me këtë çashtje**; **atij i duel puna mbarë gjithëkundi ndër luftime**; **tek e mramja e frynë ballonën me hidrogjen e ju duel mirë**; **doli i lik**; **duall i gënjyer**; **dal i lamë**; **le të dalë ku të dalë = gjerm; mag es ausfallen wie es wolle**; 11. **dal në pension**; **dal në dritë**; 12. **duel fjala rrenë, duel fjala ime = u vërtetua**; 13. **nuk më duelën (= mjaftuan) paret**; **nuk na dalin drutë, edhe na mehen**; **nuk ja del me pare** (se duhen shpenzime të mëdha të shkosh deri atje); 14. **e kurrnjena s'mujte me ja dalë kah urtija**; **e ai ja duel me nder = pati sukses**; **ja del shumë viseve të botës (= ja kapërcen)**; **nuk i dilet mb'anë kësaj pune**; **mujti me ua dalë (= kapërcye) gjithë vështirësive që kishte pasë**; **ai iu del para punëvet me kohë = it. prevenire**; 15. **dalsh faret, lugat, mëç**; 16. **dal për të dhanë, jo për të marrë**; 17. **dal në diell = dal pa mall e pa gjë, pas një mënxyre**; 18. **dal jashtë = ndrag**; gjerm *auf den Abtritt gehen*; **bar për të dalë**; **ka dalë, s'ka dalë sot** (nënkup. jashtë).

damtuer, *f* **damtore mb**, *kalë, njeri* — = që bën dëm. FGJSh 73.

damushare mb; *dhi* — = që bën dam (Vërçë - Gramsh).

dangallak - u em; *dangaraq, me bark; është një — i mefshët.* sh. FGJSh *dangall*.

dangaraq-i em; *me bark, barkiç (Elbasan).* FGJSh 73.

dardhë-a ef; *dardhë bishtje, e derdhur (fr. fondante), dimërake, dyjkë (e pjekur - Vlorë), elbje (= e verdhë, piqet herët), gurje, e guravtë, gjatje, lang'je (me lëng), shtirë (e vogël dhe e zezë); prv. kush i rri dardhës ndën te i ha edhe kokrrat; mollën qëroje, dardhën numëroje.*

dardhishtë-a ef; *dardhë kokërvogël dhe e egër; goricë.* FGJSh 73.

darem fm; 1. shpërndahem: **u darën gjindja** (= u shpërndanë); **daren retë**, *kur shihet ylberi* 2. humb: **unë u dara përmend**; edhe **dar** = humb një send që ruhet me kujdes (Thkellë - Rrëshen).

darkore mb; *kusi* — = kusi sa për një darkë gjellë.

datosur (i,e) mb; *hidhem përpjetë —.*

degë-a ef, *shtëpia u mbush - më - me njerëz (sikur mbushen plot degët e pemëve); e njoh, e di një gjë me rrënjë e me — ; nuk i lë — e rrënjë pa i thënë = gr. τα ἄξ αμαzus, ai do — = do shkak (edhe ajozë).*

dejë-a ef; 1. vendi ku ka shkrirë dëbora (Martanesh); 2. degë fuçije; *gjerm-Daube, Daubholz; fr. douvain, douve*; 3. zog shtegtar, i madh sa një dallëndyşe (Malësi e Krujës dhe e Shkodrës).

delesy ndf. *ajo gja po ma ban — ; ah ç'po ma ban — ajo vile rrushi (= po ma bën me sy).*

delmer-i edhe **delm/uar-ori, dëlmier-i (Argjir). dylmer-i, dylmyer-i (Vlorë), dylmyr-i (Vlorë), dylmur-i (Tragjas)** em bari.

delmjel/e - ja ef; *bareshtë, ajo që mjel delet (Myzeqe).*

delmur (i,e) mb prej delje: *qumësht, djathë, mish i — (Gjirokastër).*

delpëkoj fk; *e dredh për dy herë leshin: — leshin (Vlorë).*

dell-i em shm; **deje-t** 1.: — *i ujit = rryma e natyrëshme, shtrati natyral i një rrjedhës së ujit*; 2. *e ka qafën me një — = është i dobët*; 3. *i ka plasë — i marres*; 4. *u bënë do valle që shumëkuj nuk i shkuen për — = nuk i pëlqyen.*

derdh fk; 1. përhap një lajm të mirë a të keq: *e — fjalën ndër miq (Lumë)*; 2. brydh, bridhton, shkripton: *ngrica e — tokën (Lumë)*; 3. fig. — *djersë për një punë = mundohem shumë; derdhem fm.1.: lumi derdhet; u derdh lumi; po derdhet një shi i madh*; 2. *gjithë kjo punë asht derdhë për...;* 3. *u derdh me vrap; unë u derdha dhe e pushtova djalin (që donin ta vrisnin); u derdh vetë me ushtëri shumë të madhe mbi ...; Aleksandri pas Egjiptit iu derdh Hindit; Karli e pa Italinë të përndarë dhe iu derdh ta merte; francezët, pas Italisë iu derdhnë Ingjilterrës; ay me ushtri tjetër iu derdh ta hajë; ay, me të afruar, derdhet dhe e pret*; 4. *ishin derdhë kull'e saraje = ishin prishur.*

derëmbyll/ur, - me mb; 1. për një burrë e grua që s'ka zotësi të rregullojë shtëpinë ose vehten; s'di t'i matarojë punët e veta e të shtëpisë; 2. (Gjirokastër) atij që i kanë vdekur njerëzit, i është mbyllur dera; i mjerë, fatkeq; edhe **i shuat**.

dergj fk; *shkocj, kaloj një sëmundje: e ka dergjë fruthin, kollën e mirë, linë (Lumë); dergjem fm. dergjet në shtrat; asht dergjë gjithë n'atë punë = s'po e mbaroni dergjem në kambë.*

dergjë-a ef; 1. sëmundje e madhe, e gjatë, e keqe: *ka kapë — e madhe; oftikë: e ka kapë — e keqe*; 2. hithi që i bie rrushit nga mjegulla; 3. sëmundje që u bie bimëve e pemëve, duke ua tharë gjethet a duke ua lëshuar për tokë kokrrat: *u ka ra — pemëvet.*

dergjshëm (i) mb; *shëndetlig; it. malatticio (Malësia e Veriut).*

dermë-a ef; edhe **dermë-t** sëmundje e tokës; ajo punë, ajo e tokës: *njeri me — ; i bie dermët, i ka ra dermët.*

desh *ndf*; pa lidhëzën të = **desh** kohë të shkuar: — *u zunë*; — *vrau dynjanë*; — *e vrau*; — *u vranë*; — *u ba copa-copa*; — *e ka hudhë në det*; — *theva dorën*; — *ma muer prej duersh*; — *më hangrën*; — *e banë*; — *u therën*; — *ranë në gjak, qimja e ndau*; — *gjindesh keq cuca*; me lidhëzën të = **desh** kohë + të tashme: *t'iki* = = për pak desha të iki; — *t'i bërtas*.

dëlire *fm*, 1. lirohem nga barra, lind (gruaja): *lëhona u dëlir*; 2. në të kaluarën: lahem nga faji: **u dëlir** *filani se bani be*; *do t'i dëliresh filanit apo jo* (duke ngritur porotë, ase me betim).

dëmall-i *em*; liqe me ujë (Tiranë); *krs. Bashkimi 80 dannalle*.

dëndëroj *fk*; shpeshoj, frekuentoj; *it. frequentare*; *po i dëndëron vizitat* (dhëndëri); *po i dëndëron të ardhurat* (Gjirokastër)

dëndëshor-i, -e-ja *mb. e* burrë a grua e dëndur, e trashë.

dëngërrotë *mb*; me bark të madh.

dëngëza edhe **dëngas** *ndf* plot e përplot: *e mbushi tasin — me çorbë* (Gjirokastër); *ishte mbushur oborri — me njerëz*; *hëngri një tas — me kos*; *e mbushi torbën —*; *ishte mbushur oda dëngas* (Mallakastër).

dënk *ndf*; *plasi* —.

dënoj *fk*; pakësoj: **dënoja** *ujët, tamlin*; **dënoja** *barrën kalit se e ka të randë* (Lumë); *mos i dëno kto shqerrat e ktyne deleve, po na bli një tjetër qingj, për t'ja therë mikut*; *fjk: ka dënue ujët = ka me*; *fp: u dënue gjella = u pakësua* (Elbasan).

dërkanë-a *ef*; 1. klysh derri i egër femër; 2. amë dirqsh. *Krs. Gaz 109*.

dërkim-i *em*; *bie shi* — = shi i rëndë.

dërkuj *fjk*; **dërkujta, kam dërkujtë** ha darkë (Himarë); a drekë (Kristoforidhi); *gr. δεινω (Leake 309)*; *tue dërkujtunë muor bukënë* (Buzuku 64d); *ënbassi pat dërkujtunë* (Buzuku 83l.).

dërmak (edhe **dërrmak**) *ndf*, pa bërë, pa prekur: *i kam punët* — (përdoret më fort prej plakavet); *e la — punën = pa e kryer* (Lumë); *më ka mbetë — misri, bari = pa u ngritur, pa u mbrojtur nga shiu*; *e rrahi mirë, ka mbetë* —.

dërmaq/e-ja *ef*; prishje, rrenim.

dërmë-a edhe **dërrmë-a** *ef it. disfatta; fr. défaite* (?).

dërmëhas *fk*; trëmb: *ujku dërmëhasi dhent = i trembi dhe i shpërndau: sqif-teri dërmëhas zogjt; si janë dërmëhasur këto = shpërndarë andej e këtej; si është dërmëhasur bagëtija; sin. kanë marrë shushavën; janë përdredhur* (Mallakastër). *Krs. Fj. Bashkim. - trumhas.*

dërmilë-a *ef*; prishje, rrenim.

dërmis *fjk*; kotem (Shkodra); falem (Gjirokastra).

dërmon-i *em*; shoshë me vrima të mëdha, për të shoshur grurin (Opar); përdoret më tepër në lëm, për të ndarë kashtën (më të gjatë se kokrrat) nga gruri; 2. satac. *Krs. gr. δρομοxl, it. gran crivello*.

dërterë-a *ef*; *shm. dërterë-t: ka mjaft aso dërterash ajo shpi: jo rrushin, jo pemët, jo ullijtë* (Shpat).

dërthë-ja *ef*; dredhëz, luleshtrydhje; *it. fregola* (Librazhd).

dëshfënjej *fk*; shqyej, bëj copa-copa (Gjinar-Elbasan); *krs. shkafanjej e shkafanjis* (Elbasan).

dëshpjerë *mb shm*; **dëshpjera** çahje: *pjeshka dëshpjera = pjeshkë që çahen dhe u del bërthama* (Himarë)

diell-i *em*; *ka ra — i = ka perënduar* (Veri); *ka rënë — i = ka lindur* (Jugë); *e ha, e rrok, e rref — i ate shtëpi; kjo ndodhi ditën për — ; s'e ka shoqin kah ban — i dritë* (është i zoti fort); *nuk bahet — ai t'i ngrofti të gjithë* (duke i mbajtur me ushqim e me veshje); *vjen i uritur si — i tek e ëma = i uritur shumë* (plakat thonin se dielli niset në mëngjez dhe kthehet tek e ëma në mbrëmje i uritur nga lodhja udhës që bën tërë ditën).

dikë-a *ef*; dëshirë: *mnija e zezë vite për ditë ma e ma tue e bree, e — a e tij*

me ja çilë gropën Jules një sahat e ma parë; krs. Fj Bashkim. 87.

dikoj *fk*; shpraz, derdh: **dikon** hiret e veta mbi njerëzit; po **dikon** shi, po **dikon** breshën.

diktesë-a *ef*; diktim: **diktesën** e bani tui vu roe se kualt nuk pijshin ujë aty; krs. Fj Bashkim. 37.

dimarak, -e edhe **dimrak-e** *mb* dimëror; *rrush* — = që piqet në nëndor; *mollë a dardhë* — e (a **dimrake**) = që piqet në shtator e tetor.

dimërim-i *em*; të dimëruarit: — **i** *i* bagëtime.

dimëroj *fjk*; kaloj dimrin: — në një vend.

ding edhe **dingsa** *ndf.plot*: ishte mbushë shtëpija — (Elbasan); *qe mbushur* ; *pjergullat ishin dinga* (Gjirokastër); fort: **ding** u gëzova (për një lajm të mirë) (Iballë Pukë) krs. Gaz 110.

dirë-a *ef*; gjurma e kafshëve të egra (Polis-Elbasan).

ditar-i *em*; masë toke. aqë tokë sa punojnë qetë në një ditë.

ditë-a *ef*; shm. **dit-ët**: *sot kam — n për ke doktori* = afatin; në -t tona = në kohën tonë (shumësi **ditë** - me kuptimin kohë); në -t të akëcilit, gjerm. *zur Zeit von*; *jam a ndodhem në — të keqe*; *e tek vuante ajo mb'atë — mbyllturë nënë dhe* (Bleta, zi, 276, 297); *arrimë në një — të zezë*; *mbetem në — të keqe*; *vështroni se në ç' — e solli vehten* = në ç'gjëndje; *kur e pa vehten n'atë —* ; *vuajtjet e kanë prurë në këtë —* = gr. εἰς αἴτριπ τῶν κατασ. ταμ; *ka ardhur në — të pikës* = = gr. καυήν ηαυωσ; *janë në — të hallit*; *ka ardhur në — të keqe*; *e tek vuante ajo mb'atë —* (M.P. 297); *asqeri i ngratë thyerë e prishurë mbë — të keqe* (ibid. 282); *po të shëkoni se kordha zu të pikonjë gjak, të delni të më kërkoni se do të ndodhem mbë — të keqe* (ibid. 276); *ja gjeta —n* (kohën për keq); *gjeta —n* (gjeta kohën e duhur për t'i bërë ndonjerit dishka të mirë); *do të ja gjej —n*; — **a** *që vjen ma mirë bahet*; — **a** *që vjen po bahet me keq*; — **a** *që asht —* ; *rritet — e për —* ; *gjithë —n e —s*; *kur të piqen dy — bashkë* (punë e pamundur); *kthen —a* = gr. ζυμερώνεται (L. 336); *u thye —a* = gjerm. *der Tag geht zu Ende*; *e di si — nusje*; *iu bafitë —a një mijë*; *t'u rittë —a t'u bafitë një mijë*; **ditt** *e glata* (për ngushllim = vetë shëndoshë) (Arb. e It.).

ditoj *fjk*; kaloj ditën: *kanë ditue qetë, dhentë*; **ditojnë** *dhentë*.

djathar-i *em*; ai që bën djath në stan.

djathët/uar - ori *em*; djathanik; byrek me peta e me djathë.

djeg *fk*; **djeg** *dru, tjegulla, thëngjill*; më **djeg** *dielli*; të **djeg** *brisku?* = gr.

πε τσούφουλ?; it. *ti bruccia?* të **djeg** *që diqte sot dielli*; më **djeg** *kuleta*; *atyne nuk i djeg fëmia huej* (= nuk u dhëmbet); më **dogje** *zembrën*; *zembrën po ma djeg dashnia*; *digjem fm digjem për ujë*; *po digjem në dhe të huej* (prej mallit); **u dogj** *pas atij*; *m'u ka djegë shpirti* (për ndonjë hidhërim a vdekje); *m'u dogjën zorrët për ty*; më **digjet** *shpretka për ty* (me ironi).

djegari-a *ef*; brengë, hall, hidhërim; *kam pasë shumë — këto dite*; *due të hek — në e zembrës sime*.

djegë-a *ef*; më *la —* ; *ja lashë —* (Elbasan) = *ja lashë takë* (Shkodër).

djeginë-a *ef shm*; **djeginë-t** 1. ushqime që të djegin në stomak, si speci, piperi etj.: — **a** *mos ha*; 2. — **a** e shpirtit.

djegurishtë-a *ef*; vend i djegur për ta bërë pastaj arë (Pogradec); krs. **përcëllimë-a** (Elbasan).

djepsor-i *em*; fëmi në djepe (Martanesh).

djergësore-ja *ef*; lehonë, e djergun (Mirditë).

djersueshëm *ndf*; *mos pi ujë —* = duke qenë me djersë (Tiranë).

djerraditë *mb*; ai që bredh andej këndeje dhe e shkon ditën pa punë (Mirditë), sh. FGJSh.

dliir *fk*; *unë e dlira* = e lava; gr. ζυτροδε; 1. dëllir; pastroj vendin, shtë-

pinë; 2. ngij, ngop: **e dlira më revani**; -em: *kur bie më mish hekëkeqi dliret së ngrëni* (Labëri); edhe me kuptimin **dëlirem**: **u dlira** = u lehtësova nga barra (gruaja); nga faji (se bëri be).

dlirës-i em; larës; gr. μαρτος ἀεοζοζίας.

dobëtohem fm; dobësohem.

dobëtuar (i, e) mb; i dobësuar.

doçarrekë-a ef; lodër kalamajsh; hapet një gropëz; një fëmi qëndron afër saj gadi me shkop në dorë; një tjetër hedh doçen; rreket ky i fundit e kështu me radhë (Tiranë).

dojtë((i) mb; 1. delikat nga trupi (Himarë); 2. jo i zoti, pa vlerë (Vlorë) (ndoshta lidhet me fjalën **dojmë-a** = pasiguri. Sh. Gaz 111).

dokë-a edhe **dok-u** (Myzeqe) shm; *doka-t* popël, plis, gogël, dheu, gur balte; **zbardhin** —at e ugarit për ujë; *ara mbeti fjesht* —a e sukuj; *lesës veri gurë të gjallë që të shtypen* —at (Tomorricë).

dokroj fjk; them dokrra (Elbasan)

dollmë-a ef; hendek i madh me dy mezhdra.

domërr-i em shm; **domërre-t** kulmi i një sendi a pune: — *pune*; — *bulmeti*; — *fare* etj.; *ta zë shul miku mu në — të punës*; —i i *bulmetit është shëngjergji*; —i i *farës është shënpjetri* (Myzeqe).

domkë-a ef; zhungë, bullungë, që del në trup nga të vrarët, të përpjekurit; **Sin xhomkë, xhumkë.**

domkë mb shm; **domka**: *domate domka* = të mbushura

domna: *jam ndër* — ; *kam ra ndër* — = as andej, as këndej.

Krs. fshatin e Shkodrës **Domna**.

donatare-ja ef; grua shumë e zonja, që di të matarojë punët e shtëpisë e të presë e të përcjellë miqtë (Jugë).

donati ef; stoli, zbukurim: *O pallë a, / që ke dal'nga Paramithia*.

dongare-ja ef; 1. kockë e madhe (e kalbur?); 2. rrënjë të një druri të tharë e të trashë. (ndoshta nga **dokrë, do(n)krare, dongare**).

dorbar-i em; harbut, i vrazhdët, në fjalë e në vepra (Gjirokastër).

dorcak-u em shm; **dorcakë-t** 1. dy dorëzat e bishtit të kosës; 2. harku i lakuar në formë hënëze me të cilin i bihet telit të lahutës.

dorcor/e-ja ef shm; **dorcore-t** dorcaku i kosës; dorëza e bishtit të kosës.

dordogan, — e mb; fjalë që tregon madhësi trupi njeriu, kafshe, bime a sendi; *Spiro Gjata — njeri*; —ët *kuaj janë për sufarinj*; —ët *vidha*; *grua, pelë, buacë* —e; —et *arra*; —et *pisha* etj.

dorë-a ef; 1. vegjë: *dora e shpatës, e gjymçes, e qypit*; 2. masë sa merr një —, pak gjë: *bani ato libra dhe mori një — pare*; *nji — asht kjo*; *një — plak jam unë*; *një — eshtra*; *ishte ba një — prej idhnimit, prej hallesh, prej pleqnisë* = ishte dobësuar, rrëgjuar, zvogëluar; *u ba një — nga frika* (Elbasan) = u mblodh, u tkurr; 3. kategori, cilësi; —e *parë*, —e *dytë*; *nji — (njisoj) janë të dyja kto punë*; *ai është nga —e popullit* = nga shtresa e puntorëve; *i sëmuri është një — = një soj*; *fisit sinë e ndoret sonë* (Bardhi); *as nde ndonjë tjetër dorëgjindje përmbi dheet* (Bardhi 62); 4. pushtet, pronë: *këto kam në — = gjerm. über etwas verfügen*; fr. *disposer quelque chose*; *nuk e kam unë këtë në —*; *për shumë kohë deti ish në —të tyre*; *e ka —n të gjatë*; gjerm. *mächtig, gewaltatig*; *ma le mua në — që t'ja ndreq samarin* = gjerm. *uberslassen*; *e ve në — ai e vu në — gjithë Finikinë*; *e shtie në — = gjerm. ich bemächtige mich, eigne mir an*; *me e lëshue n' — t'tjetërkujt*; *fus në —*; *ta ve në — nji herë unë stofën*: it. *acquistare, possedere*; *më duel nga —a*; *nuk bie në — (fëmia, se nuk donte të qethej)*; *bie në —të ndonjërit një libër a një gjë tjetër*; *nuk më ka ranë në — ai libër*; gjerm. *es ist mir unzuganglich*; *e marr në — nji punë* = marr iniciativën: *bahem — = marr iniciativën*; *ja shtrij —ën (J.) i hedh —n*; *ja ngjis —n (V) = i ndihmoj*; *shtrini, zgjati, ndëri —n (Mat. XXVI 51)*; *më ka dhanë — = më ka ndihmuar*; *më dha — ajo që punova edhe*

për të djela, që e mbarova shpejt punën; me murin që ngrita më dhanë — gurët e mëdhenj që pata; m'ep — të ... = gjerm. die Umstände, Verhältnisse gestatten mir, ich bin in der Lage, es passt, konveniert mir zu...; rum. imi da mină sã...; asht e dijtun se ngutësija nuk i dha — me e përshkrue të tanë librin ashtu si lypet; mbaj ose ve — n mbi krye = përkrah; fr. encourager; mos ve — në këtë gjellë, punë etj. = mos e prek, mos u merr; i bane — qershirë? = i fillove? na mbanin në — (ush-tarët tanë në Jugosllavi) = na mbanin me nderime (krs. e mba në pëllëmbë të —s); e la mbas — = gjerm. ubersiehen, fr. ne faire pa cas; i ap duert = e përzë; ja kam marrë —n (edhe jam ba arak); atij i zë —a = është i zoti, bën gjëra që nuk janë të zanatit të tij; i vjen për ndorash (Elbasan); e ka prishë —n (për një zanatçi që nuk i bën më punët e tij si përpara); ke ato ze —a mirë = merr pare, fiton; kaqë zu —a; më zu —a pare; i dridhet —a, kur jep një lekë (është kurnac); i del në shpinë të —s (për një njeri që është kurnac); nëqoftëse të ka —a (xhepi), epi atij; kur mundën (ai) e i sos —a (atij) me e baam = kur i vjen kollaj, ndorash (Budi); tue i thanë se kuur do të sosnjë —a me më nkthiem gjaanë teme ti merr tandenë (Budi. Pasqyra 65); rri me duar në gji, rri me duar n'ijë; rri me duar mbërthyer, rri me duar kryq (kur s'bën gjëkafsh njeriu); ve — në zemër = mos kërko kaqë shtrejtë; askush tjetër përmbi ta — s'munë shtjerë (s'mund të vërë dorë) (Budi, Pasq. 61); vuftë — (për të na mbrojtur); mos na lëshoftë — e; po bajnë propogandë me gjithçfarë ç'u del prej —e; me gjithë duer gjellësh = me gjithfarë gjellësh; lutij për ata që u banjënë gjithë duortë e dhunive (Pasqyra 52); lini të vegjëlitë.. përse atyne anso — e anshtë regjënia e.. = për të tillë është; muer mend në —; më dha mend në — (i sëmuri); do t'i lajmë duert nga ajo gja = it. saremo privati; gr. δά στερυδωμεν; me ja njomë —n, e za për —e; kapem a rrokem — për —e; i mshoj —n, i randoj —n; qish — njeriu asht (Budi); qish — lëngimi o plage (Budi); t'i krahasojmë këto —et (këto farë) ndiesa; as ndë lundronjënë ndër gjithë duortë begativet (Budi) = në çdo farë begatie; me ndimuem së pafatësë dorësë arbëneshe (Bardhi); për duer e për thonj s'e ka shopen; unë i laj duart = jam pa faj; i lau duart nga lufta e Vlorës, duke deklaruar se Vlora nuk ish nën juridikcionin administrativ të saj; të mos lajmë duart e të themi se u mbarua puna; i lau duart nga ai (nga djali që i iku në Amerikë); dy duar për një gojë = mjaftojnë që t'ushqejnë një gojë, sido që të jenë kushtet e jetës; dy duar për një kokë = dy duar janë mjaft për të mbrojtë; ve duert në krye (për një fatkeqësi); përplas duert, përpjek, rraptoj, trokas duert.

dorëcore-ja ef dhe mb; që bën mirë çdo punë dore, çorape, qëndisje etj; grue — ; asht — (Lumë).

dorgom, — e, mb; **dordogan**: fjalë që tregon madhësi; — djalë (Myzeqe).

drangoset fm; forcohet dhe dhemb: sisa, kur ka shumë qumësht —; kështu mund të — edhe ndonjë pjesë tjetër e trupit (Gjirokastër)

drashtë-a ef; shportë e rrumbullakët.

dregë-a ef; krodha që zë sipër plaga; prej së palarës i kanë dalë — a në fytyrë (Korçë)?

dregëzohet fm; zë dregëz plaga (Gjirokastër).

drek fjk; (dreka; drekja, do të drek, kam drekë a drekun) ha drekë (Jugë); eni e drekii (Buzuku Gjoni XXI 12); mbasi ka drekunë (Buzuku fol. 22 v)

drekām fm; (u dreka, drekesha, do të drekem, jam drekur) ha drekë.

dridhem fm; **dridhet** i tëri; **dridhet** si purteka nd'ujë; më **dridhen**, i **dridhen** leqt e këmbës; më **dridhet** buza kur e thom; më **dridhej**, i **dridhej** gjuha; krs. rum. tremura limbă; **dridhem** për atë edhe **dridhem** mbas atij = e dua fort.

drinjë-a ef shm; **drinja-t** karthia (Kolonjë).

driptoj fjk; depërtoj (*derp(ë)toj, *dreptoj, driptoj).

dritë-a ef; 1. **drita** venit, porritet, fiket, shuhet, ftohet, ndalet; — e mekun; 2. shkëlqim: nuk ban — llamba se s'ka voj, ase s'ka fuqi elektrik; 3. send që jep

dritë: *ka punuar në t'errët, pa ndonjë — në dorë; njeriu kish një — të madhe, që s'e kish tjetër kafshë, mendjen; 4. — a e syrit fig. = gjëja më e dashur; fig. na nxori në —, na qiti në —; i kishte fëmjtë si — a = të bukur, të shëndetshëm; e priti si — a diellin: me gëzim, me qejf; rroka dritën me dorë = gdhiva gjithë natën.*

drithtë (i,e) *mb*; i dredhur: *pe i —; përllhura duhet të ketë pe të — (Mat).*

drizak-u *em*; zog i madh e i larëm sa një mullenjë ose gargull.

drizë-a *ef*; *e kam fytyrë —; m'u ka ba krahnori — prej tymit.*

drobis *fk*; qëmtoj (mbledh) sende që janë të rralla e që janë të shkoqura, të përdredhura: — *koqe fasulesh nëpër baltët; mos rri kot, or plak, drobit bathët të shkoqura në bathoretë (Myzeqe).*

droçkë-a *ef*; grimcat e kosit a të djathit që mbeten në hirrë (nga ***dromçkë**, **dromcë** = thërrime buke): *kjo hirrë qeka e mirë se paska — a (Bashkimi 94: droçkë).*

droçkël-a *ef*; *enë baltje për ujë (Lumë); doçe (Tiranë); guçe (Korçë).*

drokth-i *em*; 1. dra i gjalpiti (Tiranë); 2. zbrokth (Gazulli 115; krs. po aty **rokth, obrokth, zbrokth**); 3. karthëpulë (Malësia e Krujës dhe e Shkodrës).

drokull-a *ef shm*; **droklla-t** kodër; *kjo copë rrugë asht ba — (bërdokëll-a), bdrokull = it. torchio?*

dromak-u *em*; druri i bishtesë së gomarit; *sin. strokal (Malësi).*

drueshëm (i) *mb*; që të shtie frikën.

druhem *fm*; kam frikë; stepem: *druhen nga...; kurdo ua ka frikën dhe druhet prej syresh, prandaj s'mundemi të themi se s'druhen prej nesh; pse të druheç, nuk ka njeri; gr. συστεργουμαι.*

drumbe-ja *ef*; pyll i dendur, i mpleksur; krs. **Dumbrë**; mundet nga ***druné**, (plural i *dru* > ***drunbé** > **drunbé** > **dumbré** > **Dumre**. Krs. sl. *dërbo* = *dru*,

drunckë-a (edhe **drunçkë-a**) *ef shm*; **druncka-t** 1. misërishteja e misërit të njomë o të thatë: *sivjet misri nuk e trashi — n, se nuk ra shi; — at çojnë tym të hidhur kur digjen (Tomoricë); 2. mbulesë enësh e bërë prej misërishtje ose prej leckash: vëri — n shtëmbës se mos bjerë ndonjë mizë; bëji një — kotruves se derdhet.*

drunjosur (i) *mb*; *mbeti si i —.*

druth-i *em*; inat; *e zu — (Elbasan).*

dud-i *em* njeri pa dhëmbë (Malsi)

dudë-a *ef shm*; **duda-t** trysë, mishi i dhëmbëvet: *asnji dhamb s'ka në gôjë e ha vetëm me — at (Dibër).*

uf-i *em* inat; fr. *indignation*.

dufarak-u, — **e-ja** edhe **dufrak**, **dufrak** *mb* dhe e 1. pemë, dru, lis që nuk hapet degash, por rri mbledhur kaçup (kufarak?); 2. djalë, njeri i ngjallur, i bëshëm, e i shkurtër.

dufëroj *fk*; bëj shuk; rruadh, zhubravit, tutloj: **dufëro** *një shami, një petk; ja dufërova flokët; fr. chiffonner (Elbasan); fm, dufërrohem petkash, flokësh = tutlohem Krs. dufrrak.*

dufurroj *fk*; bëj me çapa, zhubravis.

dugjet *fm*; duget; *kur dardhishtat (dardhat e egra të pashartuara) vihen ndër kapa bari dhe zbuten, thuhet se dugjen apo zdugjen.*

duhanishtë-a *ef*; tokë e mbjellur duhan.

dujk-u *em*: *i kllas — n; fr. abandonner; i dha — n; i kalli — n; gr. ἐξδτεζος (M. Kolea).*

duk *fj plk*; *as dii cë — më qëndron (Antol. 19) = it. non so che bene mir imase; ndë të dajtur dukt e petkut (Ant.23) = it. nel dividere i redditi del podere; dukt e së Bënës (ibid. 23) = it. il compensa dell'opera; dukt e punës të vet = it. utile (ibid. 25).*

dukakeq-i, — **e-ja** *mb em*; shafakeq (Polis-Elbasan)

dukë *fj plk*; duk; *buk'e grinjë ka —, se s'bëhet thërrime; nuk ka — djathi, vaji; s'pati — ajo, se na iku shpejt; s'më ka — (Korçë), s'pati — gjella; i jipte të*

holla, po s'i kishin — , se ai i loste; foli ti atij, se fjalët e mia s'kanë — it. effeto) tek ai; nuk më ka — fjala; mirëpo fjala e jonë nuk kishte aqë — sa ajo e tij.

dukë-a *ef; duen me u bamun — n'veti.*

dukë (të), **dukur** (të) *eas: ma mirë marrim mish, se peshku s'ka të — ; më pat të — mishi; s'ka të dukur (ajo gjellë); e paske grisë këmishën, s'të ka të — gja tyf.*

dukur (i) *mb, ai që ka të pamë, i pashëm, i hieshëm: trima të— fr. representable, it. rappresentabile (Himarë).*

dum *fj plk; s'jap — = nuk ja gjej dot fillin (çështjes), nuk di ta zgjidh; hajt e jepi — ksaj pune.*

dumatem: *më vjen ndër mend; gjerm. einfallen. (Mirditë).*

dumbak *mb; fryrë: është fryrë, është bërë — ; ose vetëm: është bërë — (Gjirokastër). Ky moj dume.*

dumbë-a *ef; dumkë: i ra me një —.*

dumkë-a *ef; shm; dumka-t* të mbledhurit e dorës ose të goditurit që bëhet me dorë të mbledhur: *e zuri me —a = e rrahu me grushte; e handakosi — ; më handakosi krahët me —a; fig. i shëndoshë, po i shkurtër: e ka djalin — ; ajo mbeti sa një — ; ai është — ; e ka qesenë — = plot me të holla; ai është — me të holla (Gjirokastër).*

dunkth-i *em; qimet e gjata që i rriten kalit në pjesë të poshtëme të këmbës nga ana e pasme sipër thundrës (Zadrimë); krs. tunçe-t (Elbasan).*

durakës-i, —**e—ja** *mb; i duruar (Himarë).*

duresë-a *ef. durim: me ba —; baan me — të shumet; e bari nji gja me — ; e bari me — nji të keqe.*

dushnjer/e-ja *ef shm; dushnjere-t* *dushk i imët: dëgjojmë një fësh-fëshe të lehtë nëpër gjethet e thata të dushnjereve.*

dushkat *eshm: i dha — = i dha arratinë, e zboi.*

dushkonjë-a *ef shm; dushkonja-t* 1. dru dushku e prerë për zjarr: *bëna ca —a për furrë; drutë —a shiten me të lehtë (Myzeqe);* 2. degurina dhe gjethe dushku të mbledhura verës dhe të ruajtura për ushqim dhish e dhësh dimrit (Tomorricë).

duzi *em; i ra— = i vari turinjte, iu prish qejfi (Vlorë).*

dylmereshë-a *ef; stanore, stopane (Dukat - Vlorë).*

dyltme (e) *mb; bukë — = bukë e butë.*

dylti *mb; bukë — = bukë e butë.*

dynd *fk; çoj në këmbë për një qëllim të caktuar: dyndi top e ushtri; dyndem fm shpërngulem, shkulem: prej Preze janë dyndë shumë rob e kanë zënë vend në Durrës e Tiranë (Prezë-Tiranë).*